

NJOFTIM
Nr. 19558, datë 30.10.2019

**PËR MARRJEN PJESË NË TRYEZAT E DISKUTIMIT DHE TË KËSHILLIMIT,
NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN**

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019, “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për Integrimin Evropian”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e institucionit drejtues të kapitujve:

- kapitulli “Kriteri ekonomik”;
- kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”;
- kapitulli 2 “Lëvizja e lirë e punëtorëve”;
- kapitulli 3 “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”;
- kapitulli 6 “Legjislacioni për shoqëritë tregtare”;
- kapitulli 7 “E drejta e pronësisë intelektuale”;
- kapitulli 16 “Tatimet”;
- kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”;
- kapitulli 28 “Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik”;
- kapitulli 29 “Doganat”;
- kapitulli 30 “Marrëdhëniet me jashtë”;
- kapitulli 32 “Kontrolli financiar”;
- kapitulli 33 “Financat dhe buxheti”;

fton të marrin pjesë lirisht në Tryezat e Diskutimit dhe të Këshillimit, në kuadër të procesit të Integrimit Evropian, të cilat krijohen në mënyrë analoge me kapituj e *acquis* të Bashkimit Evropian, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, të medias dhe të grupeve të interesit, referuar përcaktimeve të kreut III.2, pika 4, të urdhrit.

Sipas përcaktimeve të kreut III.2, të urdhrit të Kryeministrit, aplikimi për t’u bërë pjesë e Tryezave të Diskutimit dhe të Këshillimit kryhet nëpërmjet dorëzimit të një letre interesi, si dhe CV-në e personit apo të grupimit që përfaqëson, duke treguar se kanë ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezat specifike.

Personat apo përfaqësuesit e grupeve të interesit mund të paraqesin dokumentacionin e sipërcituar për pjesëmarrje, brenda datës **11 nëntor 2019**, në adresat e mëposhtme elektronike të sekretariateve teknike të GNP-së, sipas kapitujve më poshtë;

- kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”, kapitulli 3 “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime” dhe kapitulli “Kriteri ekonomik”: Kevin.Treska@financa.gov.al;
- kapitulli 6 “Legjislacioni për shoqëritë tregtare” dhe kapitulli 30 “Marrëdhëniet me jashtë”: Eva.Hamitaj@financa.gov.al;
- kapitulli 7 “E drejta e pronësisë intelektuale”: Sonila.Meka@dppm.gov.al;
- kapitulli 29 “Doganat” dhe kapitulli 32 “Kontrolli financiar”: Minushe.Malia@financa.gov.al;
- kapitulli 2 “Lëvizja e lirë e punëtorëve”, kapitulli 28 “Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik” dhe kapitulli 33 “Financat dhe buxheti”: Jetnor.Kasmi@financa.gov.al;
- kapitulli 16 “Tatimet” dhe kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”: Ilda.Pashaj@financa.gov.al.

Përzgjedhja e personave apo e përfaqësuesve të grupeve të interesit do të bëhet sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019.